



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË ELBASAN

URDHËR

Nr. 32, datë 31.03.2021

“PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS PËR VITIN 2021 DHE AKTEVE BASHKËLIDHUR TIJ, NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË ELBASAN”

Në mbështetje të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", në Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan" të miratuar me Urdhërin nr.8 datë 21.01.2021 të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, ligji, 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe në ligjin nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit"

Me qëllim :

- *Rritjen e transparencës në veprimtarinë e prokurorisë ;*
- *Garantimin e pjesëmarrjes së ligjshme të subjekteve procedurale në hetime ;*
- *Forcimin e besimit të publikut në veprimtarinë e prokurorisë ;*
- *Garantimin e të drejtave të subjekteve procedurale ;*
- *Garantimin e të drejtës kushtetuese për informim ;*
- *Garantimin e pjesëmarrjes dhe aksesit të publikut në veprimtarinë e prokurorisë ;*

URDHËROJ :

1.Miratimin e Programit të Transparencës për vitin 2021 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan (aneksi 1 bashkëlidhur).

2.Miratimin e Modelit të Kërkesës dhe Regjistrimit të Kërkesave dhe Përgjigjeve në Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan (aneksi 2 dhe 3 bashkëlidhur).

3. Programi i Transparencës, Modeli i Kërkesës dhe Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve afishohen për njohje nga publiku në vendin e njoftimeve në pjesën hyrëse të godinës së prokurorisë. Një kopje e tyre i dërgohet për botim në faqen zyrtare edhe Prokurorisë së Përgjithshme.

4. Me mbajtjen dhe administrimin e Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve ngarkohet Kancelarja Znj. Alketa Kurmaku, e cila është caktuar nëpunës civil e marëdhënies me publikun dhe koordinatore në përputhje me ligjin "Për të drejtën e informimit".

5. Trajtimi dhe ndjekja e kërkesave për informacion dhe kthimi respektiv i përgjigjeve kryhet sipas procedurës së përcaktuar në urdhërin nr.12, dt.04.02.2020 të Drejtuesit të Prokurorisë.

6. Një kopje e këtij urdhëri i komunikohet të gjithë stafit të kësaj prokurorie nëpërmjet postës elektronike zyrtare @pp.gov.al.

7. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTUESI I PROKURORISË

Kreshnik AJAZI





REPUBLIKA E SHQIPËRIË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË ELBASAN

PROGRAMI I TRANSPARENCËS VITI 2021

PËR PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË ELBASAN

I. HYRJE

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" është përgatitur programi i transparencës për Prokurorinë Shqiptare. Ky program përcakton kuadrin ligjor të veprimtarisë së prokurorisë në përmbushje të kërkesave ligjore të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" (LDI). Programi i Transparencës vlerësohet si një mënyrë konkrete, nëpërmjet të cilës Autoriteti Publik (ketej e tutje Prokuroria) ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e LDI-së. Prokuroria do të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të LDI-së.

Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së Prokurorisë, nëpërmjet pasqyrit të detajuar të tij në faqen zyrtare ecj.pp.gov.al si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/permbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse, e cila prodhon ose administron dokumentin.

Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë.

Dokumentacioni i bërë publik, do të jetë i përditësuar në formë dhe përmbajtje. Faqja zyrtare e Prokurorisë është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë, në format lehtësisht të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale, për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, etj.

Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta, bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga organi i Prokurorisë.

Në programin e transparencës janë të specifikuar kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t'u bërë publik, mënyra e publikimit, si dhe parashikimet ligjore prej të cilave lind detyrimi për publikim. Në publikimin e informacionit, duhet të mbahet parasysh interesi i publikut si dhe të mundësohet aksesimi lehtësisht i informacionit publik.

Skema e publikimit paraqitet nëpërmjet tabelës përmbledhëse të evidentuar në këtë program.

II. PARIMET E PËRGJITHSHME

Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi Transparencës së Prokurorisë janë:

1. "E drejta për informim": është e drejtë Kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshme nga të gjithë pa asnjë përjashtim.
2. Prezumimi i publikimit maksimal të të dhënave: Prokuria ushtron funksione publike. për rrjedhojë informacioni që rrjedh nga veprimtaria e saj publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e Prokurorisë në lidhje me të drejtën e informimit. Më konkretisht: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë; Ligji 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar); Kodi i Procedurës Penale. Ligji 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Ligji nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", etj.
4. Informacioni përshatet në gjuhë të qartë e të kuptueshme.

Organ mbikqyrës i procedurave të informimit publik është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrotjen e të Dhënave Personale (KDIMP).

Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij.

III. INFORMACIONI QË BËHET PUBLIK PA KËRKESË

Informacioni që bëhet publik pa kërkesë duhet të jetë: i plotë, i saktë, i përditësuar, i thjeshtë në konsultim, i kuptueshëm, lehtësisht i aksesueshëm, i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të organit të Prokurorisë.

Informacioni i lejuar për publikim është shprehimisht i parashikuar në nenin 7 të ligjit Nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit".

Në përputhje me këtë program transparence, të miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm, vendosen në dispozicion të publikut në faqen e internetit ee.pp.gov.al, si edhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- Struktura organizative;
- Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë;
- Funksionet dhe detyrat e Prokurorisë;
- Përshkrimi i procedurës së caktimit të prokurorëve, kompetencat dhe detyrat e tyre, procedura që ata ndjekin për të marrë vendime;
- Tekstet e plota të konventave që janë ratifikuar, të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, apo ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të prokurorisë dhe që prek publikun e gjerë.
- Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit.

- Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatesisht, sipas parashikimeve të ligjit nr.9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr.125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të Prokurorisë, duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura, shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve mallrave të kontraktuara, informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme
- Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumenta që përmbajnë tregues të performancës së Prokurorisë.
- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim;
- Adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit.
- Afatet dhe mënyrën e kthimit të përgjigjeve, procedurat e ndjekura në vendimmarrje;
- Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime me karakter të përgjithshëm ose për kategori të veçanta, bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit, përveç atyre që merren në kuadër të një procedimi penal.
- Procedurat e ankimit të vendimit përkatës.
- Procedura, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo menyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të Prokurorisë, një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë.
- Informacioni i publikuar sipas kesaj skeme, perditesohet sa here ai ndryshon.

Prokuroria, gjithashtu, krijon dhe arkivon një kopje dixhitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kerkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë.

IV. TABELA PERMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË PROKURORISË

Kategoritë e informacionit publik	Baza Ligjore	Dokumenti / Përmbajtja	Afati kohor	Mënyra e publikimit	Struktura përgjegjëse
Përshkrimi i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik	Neni 7/1/a/d ligji 119/2014	Skeme / Tabela e funksioneve	Pas miratimit të programit	Në faqen zyrtare, në rubriken “Rreth nesh”	Prokuroria
Akte ndërkombëtare ligje; akte nënligjore; dokument	Neni 7/1/b ligji 119/2014	Kushtetuta / Akte ndërkombëtare / Ligje / Akte nënligjore të Prokurorit	Pas hyrjes në fuqi të programit	Në faqen zyrtare, në rubriken “Legjislacioni”	Prokuroria

politikash; dokument tjetër.		Përgjithshëm			
Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës.	Neni 7/1/c/g Ligji 119/2014	Kërkesë sipas formatit bashkëlidhur (aneksi 1) Adresë postare: Adresë emaili:	Pas miratimit të programit të transparencës	Në faqen zyrtare në rubrikën “Programi i Transparencës” dhe “Rreth Nesh” (struktura)	Magjistrati për marrëdhëniet me publikun dhe median Koordinatori për marrëdhëniet me publikun dhe median
Te dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit	Neni 7/1/5 ligji 119/2014	Sipas rrethëve ORARI: e Hënë - e Premte Ora 8:00 – 16:00	Pas miratimit të programit të transparencës	Në faqen zyrtare në rubrikën “Rreth Nesh”- struktura	Koordinatori për marrëdhëniet me publikun dhe median
Përshkrim i procedurave të zgjedhjes, kompetencave të funksionareve të lartë dhe procedura e ndjekjes për marrjen e vendimeve.	Neni 7/1/d ligji 119/2014	Parashikimet ligjore të neneve, 148/al48/b të Kushtetutës; Kreu IV i ligjit 97/2016; Ligji 96/2016; K.Pr.Penale.	Pas hyrjes në fuqi	Në faqen zyrtare, në rubrikën “Rreth nesh”	Prokuroria
Mekanizmat monitorues; raporte auditiv; dokumentet me tregues performance	Neni 7/1/dh ligji 119/2014	Raporte	Pas depozimit në Prokurori	Në faqen zyrtare në rubrikën “Dokumente”	Zyra e Financës Kancelari Komisioni i Prokurimeve
Buxheti	Neni 7/1/e ligji 119/2014	Ligji për buxhetin dhe akte nënligjore në zbatim të tij Raporte për monitorimin e performancës	Pas hyrjes në fuqi	Në faqen zyrtare, në rubrikën “Dokumente”	Zyra e Financës
Informacion për procedurat e prokurimit	Neni 7/1/e ligji 119/2014	Ligji për prokurimet publike	Pas dërgimit në APP	Në faqen zyrtare, në rubrikën “Njoftime”	Zyra e Financës Kancelari Komisioni i Prokurimeve
Sherbimet	Neni 7/1/f	Vertetime	10 dite pune	Në faqen	Prokuroria

autoritetit për publikun.	Ligji 119/2014	Kopje aktesh/dokumentash Informacione	nga data e depozitimit të kërkesës	zyrtare, në rubriken "Legjislacioni"	
Mbajtja e dokumentacionit nga Prokuroria në sistemin arkivor të institucionit	Neni 7/1/h Ligji 119/2014	ligji për arkivat në R.Sh.		Në faqen zyrtare, në rubriken "Legjislacioni"	Koordinatori për marrëdhëniet me publikun dhe median Kryesekretaria Zyra e arkives
Regjistri i kërkesave dhe pergjigjeve.	Neni 7/1/i Ligji 119/2014 neni 8 Ligji 119/2014	Tabela (formati bashkelidhur)	Pas miratimit të programit të transparencës	Në faqen zyrtare, në rubriken "Programi i transparencës"	Koordinatori për marrëdhëniet me publikun dhe median
Informacione dhe dokumente që kerkohen shpesh.	Neni 7/1/k Ligji 119/2014	Vende vakante Statistika Njoftime për tendera		Në faqen zyrtare, në rubriken "Rreth nesh" dhe "Dokumente"	Prokuroria Zyra e Finances Kancelari
Informacione të tjera të dobishme	Neni 7/1/l Ligji 119/2014	Projekte Marrëveshje bashkëpunimi Njoftime për shtyp		Në faqen zyrtare, në rubriken "Bashkëpunime" dhe "Njoftime"	Prokuroria

V. PUBLIKIMI

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, Prokuroria vendos në dispozicion të publikut në faqen e saj të internetit ee.gov.al dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mësipërme, në një menu të veçantë të titulluar "Programi i Transparencës".

KËRKESE PËR INFORMACION

Emër Mbiemër: Z./Znj. _____	Adresa postare: _____ Adresa elektronike: _____ Nr. Tel: _____	Data: __/__/2021 Nënshkrimi:
---------------------------------------	---	---

(dërgimi i kërkesës elektronikisht kërkon emër, mbiemër, nënshkrim dhe dokument identifikimi të skanuar)

Të tjera të dhë

Forma që kërkohet informacioni / dokumentacioni: _____

Vetëm për përdorim zyrtar		
Data e marrjes: __/__/2021	Numri rendor i kërkesës:	Komente: _____

Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

- ❖ Adresa dhe kontaktet mund të gjenden nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet.
- ❖ Drejttoni kërkesën tuaj, Koordinatorit për të drejtën e informimit, të institucionit që mban informacionin e kërkuar. Kontaktet e tij, janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit.
- ❖ Kur ju mendoni se ju kanë mohuar ndonjë prej të drejtave tuaja në bazë ligjit, keni të drejtë të ankoheni tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË ELBASAN

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷

¹ Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

² Data e regjistrimit të kërkesës

³ Permbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁴ Data e kthimit të përgjigjes

⁵ Permbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁶ Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar

⁷ Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.